

Pagesa 6 mijë euro për lirim nga burgu, SPAK ndalon gjyqtaren e Apelit Korçë

Pesë persona u arrestuan ose u vendosën në masë sigurie arrest shtëpiak pas një hetimi të Prokurorisë së Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit në të cilin u zbulua se 6 mijë euro ndërruan duar për lirim nga masa e sigurisë arrest me burg të një të arrestuari për trafik klandestinësh.

Autor: [Gjergj Erebara](#) | BIRN | Tiranë



Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK). Foto: LSA

Pesë persona u arrestuan ose u vendosën në masë sigurie arrest shtëpiak nga SPAK në një rast tjetër të dyshuar për mitëmarrje në sistemin e drejtësisë. SPAK bëri të ditur se gjyqtarja Mimoza Margjeka, e cila është [komanduar](#) në gjykatën e Apelit Korçë, dyshohet se mori 6 mijë euro përmes bashkëshortit Arben Cara për të lehtësuar masën e sigurisë së një personi të ndaluar në Pogradec për veprën penale Ndhmë për kalim të paligjshëm të kufijve”.

Rasti i hetuar me “metoda proaktive”, një eufemizëm që nënkupton mbajtjen e të dyshuarve në përgjim, zbuloi se tre shtetas Nejtun Bali, Klaudio Zhilla dhe Skënder Demiraj, ky i fundit avokat, i dhanë bashkëshortit të gjyqtarës shumë prej 6 mijë eurosh. Pas transferimit të shumës, Gjykata e Apelit të Korçës ndryshoi masën e sigurisë së Orion Balit, i cili ishte ndaluar në korrik të këtij viti duke transportuar 14 emigrantë të paligjshëm nga Korça për në drejtim të kufirit malazez. Policia njoftoi në atë kohë se emigrantët e paligjshëm që dukshëm po përpiqeshin të arrinin Europën

Perëndimore përmes Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kroacisë, kishin paguar 100 euro personi për shërbimin e transportit në Shqipëri.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në Tiranë urdhëroi arrestimin e bashkëshorit të gjyqtares Arben Cara dhe dy qytetarëve Nejton Bali e Klaudjo Zhilla ndërsa dha masën e sigurisë arrest shtëpie për gjyqtaren dhe avokatin Demiraj.

Gjatë viteve të fundit, së paku nëntë gjyqtarë të tjerë janë arrestuar apo dënuar për korrupsion. Gjyqtarja e Gjykatës së Lartë [Majlinda Andrea](#) u arrestua në vitin 2016 dhe më pas u gjet fajtoresh për një ryshfet 50 mijë euro të marrë përmes bashkëshortit të tij për një gjyq pronash. Gjyqtari [Shkëlqim Miri](#) i gjykatës së apelit Tiranë u arrestua në vitin 2017 pas një hetimi mbi ryshfetin 30 mijë euro të paguar për të lehtësuar një të dënuar për vrasje. Gjyqtari [Rasim Doda](#) u gjykua pas një denoncimi se kishte kërkuar 80 mijë euro ryshfet. Gjyqtarët e apelit Durrës [Kliton Spahiu](#), [Petraq Dhimitri](#) dhe [Petrit Çeno](#) u gjetën fajtorë për dhënien e një vendimi përkundrajt një shpërbimi në natyrë, udhëtim turistik për në Barcelonë. Gjyqtari i Fierit [Roland Hysi](#) u arrestua pasi u përgjua duke i kërkuar seks një gruaje që kërkonte kujdestarinë e fëmijës në gjykatë. Gjyqtari i Beratit [Shyqyri Çobo](#) u vu nën hetim pas dyshimeve se kërkoj seks nga një qytetare që gjendej në proces divorci. Po kështu gjyqtari [Ibrahim Hoxha](#) i Tiranës u arrestua për një ryshfet 600 mijë lekësh.



RRETH AUTORIT

[Gjergj Erebara](#)

Gjergj Erebara është gazetar për BIRN në Tiranë. Ai ka mbaruar studimet për gazetari në Universitetin e Tiranës dhe ka master shkencor (MSC) për Histori Ekonomike nga Universiteti i Lundit. I specializuar për gazetari ekonomike. Erebara ka punuar që nga viti 1998 në disa media të shkruara dhe vizive Shqiptare, si gazetar, redaktor dhe kryeredaktor.